

## Ndryshimet në Legjislacion

Shtator 2017

### Në këtë publikim:

- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.09/2017 për zyrat komunale të energjisë;
- Rregullorja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të siguruesve;
- Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime;
- Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm;
- Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për lëshimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare;
- Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për instrumentet e pagesave elektronike;



### 1. Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.09/2017 Për Zyrat Komunale Të Energjisë

Ky udhëzim administrativ është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.03/154, i datës 30.08.2017, dhe ka hyr në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit të tij nga Kryeministri dhe publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Udhëzimi administrative (UA) përcakton detyrat dhe përgjegjësit për zyrat komunale të Energjisë, adresimin e çështjeve në planifikim, zbatimin dhe monitorimin e politikave të energjisë në nivel lokal. UA aplikohet ndaj të gjitha komunave të Republikës së Kosovës, në zbatim të politikave të energjisë në nivel lokal.

Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave komunale të Energjisë përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- krijimin e bazës së të dhënave dhe mirëmbajtjen e sistemit të informacionit për mbledhjen e rregullt të të dhënave mbi konsumin e energjisë në mënyrë periodike, shpenzimeve të energjisë dhe të dhënave të tjera relevante;
- zhvillimin e aktiviteteve për planifikim në sektorin e energjisë, duke u bazuar në Strategjinë e Energjisë, në mënyrë që të mbështes zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komunave;
- identifikimin e burimeve të mundshme të financimit për zbatimin e masave për efikasitet të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë të hartuara në planet komunale etj.

Mbi të gjitha, UA parasheh obligimin e zyrave komunale të Energjisë për identifikimin e nevojave trajnuese dhe zhvillimin e programeve trajnuese në bashkëpunim me Ministrinë për zyrtarët për mënyrën e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të planeve komunale të energjisë në baza periodike varësisht prej nevojave. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunat koordinon projekte të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në zbatim të programeve relevante.

## **2. Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të siguruesve**

Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës (BQK) në mbledhjen e mbajtur më 31 Gusht 2017 miratoj Rregulloren për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të siguruesve.

Rregullorja ka hyr në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e miratimit.

Kjo Rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm të licencuar nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të nenit 5 i cili nuk është i aplikueshëm për degët e siguruesve të jashtëm. Neni 5 parasheh rregullat për hapjen e degëve/subjekteve të varura të siguruesve jashtë Republikës së Kosovës.

Në përputhje me Rregulloren, Siguruesi i cili vendos të themelojë ose të zhvendosë një degë ose zyre të tij, përfshirë zhvendosjen e zyrës qendrore, duhet të dorëzojë një kërkesë në BQK dhe të marrë miratimin paraprak. Kërkesa e tillë duhet të jetë e shoqëruar nga një numër i dokumenteve që janë të listuara në Nenin 3 të Rregullores. Mënyra e njëjtë aplikohet për siguruesit të cilët vendosin të mbyllin degën/zyrë në Kosovë, dhe kërkesa e shkruar për miratim duhet të paraqitet në Bankën Qendrore të Kosovës së paku tridhjetë (30) ditë para datës së propozuar të mbylljes, dhe një njoftim i tillë për mbyllje duhet të i'u publikohet klientëve të siguruesit.

## **3. Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime**

Kjo rregullore është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 Gusht 2017, dhe ka hyr në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e miratimit.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kriterëve, procedurave dhe afateve për licencimin e ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe ri-sigurimeve. Zbatohet për të gjithë personat fizik dhe juridik, që kërkojnë licencë nga BQK-ja për tu angazhuar në veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe ri-sigurime.

Në përputhje me Rregulloren, veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime do të ushtrohet nga agjentët e sigurimeve, kompanitë e agjentëve, brokerat e sigurimeve dhe kompanitë e brokerëve. Bankat dhe agjencitë e udhëtimit mundën gjithashtu të angazhohen në veprimtarinë e ndërmjetësimit në qoftë se janë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës në përputhje me këtë Rregullore. Agjencitë e udhëtimit nuk mund të licencohen për veprimtarinë e brokerimit. Veprimtaria e ndërmjetësimit nga Banka mund të ushtrohet në përputhje me nenin 10 të Rregullores, kurse neni 11 parasheh kushtet për agjencitë e udhëtimit për të vepruar si ndërmjetësues të sigurimeve.

Ligji për shoqëritë tregtare duhet të aplikohet në lidhje me organet udhëheqëse të kompanive ndërmjetësuese. Aksionarët kryesor, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të kompanive ndërmjetësuese duhet të aprovohen nga BQK-ja. Rregullorja përcakton kriteret për tu kualifikuar drejtor dhe menaxher i lartë.

## **4. Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për Licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm**

Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës (BQK) në mbledhjen e mbajtur më 31 Gusht 2017 miratoj Rregulloren për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm. Rregullorja ka hyr në

fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga miratimi i saj.

Rregullorja përcakton kushtet, kriteret, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e një licence për një sigurues/risigurues, apo për një degë të siguruesit/risiguruesit të jashtëm.

Rregullorja zbatohet për të gjitha subjektet që aplikojnë për licencim si sigurues/risigurues dhe degë të siguruesit/risiguruesit të jashtëm, për të ushtruar veprimtari të sigurimeve në Republikën e Kosovës.

Aplikuesi për licencë si sigurues ose degë e siguruesit të jashtëm për të ushtruar veprimtari të sigurimeve duhet të ketë kapital themeltar si fond garantues në vlerë jo më të ulët se dy milion e dyqind mijë (2,200,000) euro. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të përcaktuara me nenin 7 të Ligjit për Sigurimet, atëherë kapitali themeltar nuk mund të jetë më i ulët se në vlerën prej tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro;

Përveç kapitalit themeltar, siguruesi/risiguruesi duhet të kenë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se njëzet për qind (20%) e kapitalit themeltar.

#### **5. Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për lëshimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare**

Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës (BQK) në mbledhjen e mbajtur më 31 Gusht 2017 miratoi Rregulloren për lëshimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare, dhe ka hyr në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e miratimit. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare, si dhe të rregullojë procedurën për lëshimin dhe/ose zëvendësimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare.

Rregullorja përcakton se certifikata e licencimit apo regjistrimit lëshohet për afat kohor të pacaktuar, është e pa

transferueshme dhe duhet t'i përmbaj informatat e mëposhtme:

- emri dhe logo e Bankës Qendrore të Kosovës;
- numri identifikues i certifikatës dhe data e lëshimit;
- emri i institucionit financiar të licencuar apo regjistruar dhe numri i regjistrimit të biznesit në ARBK;
- lloji i institucionit financiar të licencuar apo regjistruar;
- klauzola për anekse të certifikatës sipas nenit 3, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje;
- vendi i veprimtarisë, nëse ka;
- vula e BQK-së dhe nënshkrimi i personit të autorizuar për të nënshkruar në emër të BQK-së.

#### **6. Rregullorja e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për instrumentet e pagesave elektronike**

Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës (BQK) në mbledhjen e mbajtur më 31 Gusht 2017 miratoi Rregulloren për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave, e cila do të hyj në fuqi gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e miratimit.

Përveç kërkesave të kësaj rregulloreje, institucionet financiare duhet që gjatë lëshimit dhe përdorimit të IPE-ve të zbatojnë të gjitha kërkesat e Rregullores për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje, si dhe legjislacionin në fuqi lidhur me produktet dhe shërbimet financiare.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kërkesave dhe procedurave për lëshimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike, si dhe përcaktimi i mënyrës së raportimit të informacionit gjatë përdorimit të këtyre instrumenteve të pagesave elektronike.

Rregullorja zbatohet nga bankat dhe institucionet e autorizuar nga Banka Qendrore e Kosovës të cilat kryejnë shërbime me instrumente të pagesave elektronike.

Rregullorja nuk zbatohet për instrumentet e pagesave në formë letre dhe për urdhërpagesat elektronike të iniciuara nga bankat, për kryerjen e pagesave të ndërsjella në Sistemin e Pagesave.

Rregullorja përcakton përkufizimet e pagesave elektronike, instrumenteve të pagesave elektronike (IPE), dhe të instrumenteve të pagesave online.

Rregullorja i klasifikon instrumentet e pagesave elektronike në instrumente të pagesave elektronike me qasje në distancë, që i lejojnë mbajtësit qasje në fondet financiare në llogarinë e tij bankare nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike dhe teknike, si: kartela bankare; pagesat e menjëhershme. Shërbime të tjera elektronike bankare, si: mobile banking, e-banking, etj dhe instrumente të parasë elektronike.

Rregullorja nuk e kufizon zbatimin e saj vetëm për këto lloje të instrumenteve elektronike por do të zbatohet ndaj çdo instrumenti tjetër që zbulohet me zhvillimin e teknologjisë.

Institutet financiare mund të lëshojnë IPE dhe të ofrojnë shërbimin e pagesave elektronike përmes IPE, vetëm pasi të jenë licencuar nga BQK. Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit i Bankës Qendrore të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim së paku një muaj përpara ofrimit të shërbimeve të pagesave elektronike.

Një risi shumë të rëndësishme të cilën e sjell kjo Rregullore është lëshimi i parasë elektronike. Lëshimi i parasë elektronike sipas kësaj Rregulloreje nuk përbën aktivitet të marrjes apo pranimit të depozitave me kusht që paraja elektronike lëshohet menjëherë pas pranimit të fondeve. Si zëvendësues i kartëmonedhave dhe monedhave, paraja elektronike përdoret si instrument për kryerjen e pagesave për shuma të limituara e jo si instrument për ruajtje apo kursim.

Ky definicion ka munguar në legjislacionin e aplikueshëm duke e bërë kështu të pamundur për institucione financiare jo-bankare për të lëshuar para elektronike, sepse është konsideruar si veprimtari e marrjes së depozitave, e cila në mënyrë strikte është e rezervuar vetëm për banka.

#### **Kontaktet e Deloitte:**

##### **Afrore Rudi**

Drejtoreshë | Shërbime Tatimore dhe Ligjore

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës nr. 177,

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Mob.: +386 (0)49 590 807

Email: [arudi@deloittece.com](mailto:arudi@deloittece.com)

##### **Luljeta Plakolli - Kasumi**

Menaxhere | Shërbime Ligjore

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës nr. 177,

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Mob.: +386 (0)49 780 769

Email: [lpakollikasumi@deloittece.com](mailto:lpakollikasumi@deloittece.com)

## **Përrjashtim i përrgjegjësisë:**

Ky publikim përmban vetëm informacion të përrgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përrmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim I shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përrdorur për të marr ndonjë vendim që mund të I ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet I rrjetit te Deloitte nuk do të konsiderohet përrgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

\*\*\*

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përrfaqëson një entitet ligjor te ndare dhe te pavarur. Përrshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën [www.deloitte.al/about](http://www.deloitte.al/about).

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në saje të një rrjeti të lidhur ndërrkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhëne njohuritë tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përrsosmërisë.

© 2017 Deloitte Kosova sh.p.k.